

**ABCOM sh.p.k.**

**Pasqyrat financiare individuale të përgatitura sipas  
Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014**

## Përmbajtje

Raporti i audituesit të pavarur	3
Bilanci Kontabël	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	2
Pasqyra e flukseve të parasë	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	4
1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	5
2.1. Deklarata e pajtueshmërisë dhe bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare	5
2.2. Vlerësime dhe gjykime	5
2.3. Instrumente financiare	5
2.4. Aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale	6
2.5. Aktivet dhe detyrimet financiare	7
2.6. Zhvlerësimi	7
2.7. Njohja e të ardhurave	7
2.8. Të ardhura dhe shpenzime financiare	7
2.9. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	8
2.10. Detyrime për sigurimet shoqërore	8
2.11. Provizionet	8
3. Bashkimi i shoqërive	8
4. Vlerësimet e rëndësishme kontabël dhe supozimet	8
5. Standardet e ndryshuara të kontabilitetit	9
6. Mjetet monetare	9
7. Llogari të arketueshme	9
8. Te tjera të drejta të arketueshme	10
9. Tatime të parapaguara	10
10. Inventari	10
11. Aktivet afatgjata jomateriale	11
12. Aktivet afatgjata materiale	12
13. Investime financiare afatgjata	13
14. Furnitorë	13
15. Tatime dhe taksa për tu paguar	13
16. Te tjera të pagueshme	13
17. Garanci	14
18. Te ardhura të marra në avancë	14
19. Huamarrje	14
20. Kapitali dhe rezervat	15
21. Shitje shërbimesh	15
22. Te ardhura të tjera	15
23. Distribucioni	16
24. Kosto e materialeve, shërbime interneti dhe te tjera	16
25. Shpenzime personeli	16
26. Shpenzime administrative dhe te tjera	17
27. Situacione punimesh për nevoja të brendshme	17
28. Te ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata	17
29. Te ardhurat/(shpenzimet) financiare	18
30. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	18
31. Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara	19
32. Ngjarje pas datës së raportimit	19

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Ortakët dhe Drejtimin e

ABCCom shpk

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ABCCom shpk ("referuar më tej si Shoqëria") që shoqerojnë këtë raport, bilancin kontabël më 31 Dhjetor 2014, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin ushtimor, si dhe përmbledhjen e politikave kontabël dhe shpjegimeve të tjera, në faqet 5 deri 19.

### *Pergjegjësia e drejtimin për pasqyrat financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejte të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe për kontrollin e brendshme deri në masën që drejtimi i konsideron të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë nga gabimet apo mashtrimet.

### *Pergjegjësia e audituesit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që në të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi në lidhje me shumat dhe informacionet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare si pasoje e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e drejte të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e cmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenceja e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme dhe shërben si bazë për opinionin tonë të pakualifikuar të auditimit (pa rezerve).

### *Opinion i Pakualifikuar*

Sipas opinionin tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2014, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Tiranë,

30 Mars 2015



# ABCOM sh.p.k

## BILANCI KONTABËL

(Të gjithë shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<b>AKTIVET</b>			
Mjetet monetare	4	136,386,435	95,474,833
Llogari te arkëtueshme	5	133,183,505	135,484,404
Të tjera të drejta të arkëtueshme	6	131,527,555	83,369,041
Tatime të parapaguara	7	38,306,130	36,714,894
Inventari	8	10,952,423	10,840,847
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>450,356,048</b>	<b>361,884,018</b>
Aktive afatgjata materiale, neto	9	169,987,068	50,864,325
Aktive afatgjata jo -materiale, neto	10	2,218,823,969	2,018,166,763
Investime financiare afat-gjate	11	241,578,097	217,169,803
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>2,630,389,135</b>	<b>2,286,200,892</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>3,080,745,183</b>	<b>2,648,084,910</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
Furnitorë	12	106,267,121	223,225,696
Tatime dhe taksa për t'u paguar	13	18,708,291	18,391,538
Te tjera te pagueshme	14	153,775,389	30,080,274
Garanci	15	282,030,522	226,535,892
Te ardhura te marra në avance	16	209,655,102	182,418,630
Huamarrje afat-shkurtër	17	4,032,336	1,497,138
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>774,468,760</b>	<b>682,149,168</b>
Huamarrje afat-gjate	17	6,965,313	490,748
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>6,965,313</b>	<b>490,748</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>781,434,074</b>	<b>682,639,916</b>
Kapitali i regjistruar		1,365,244,354	1,365,244,354
Rezerva ligjore		34,427,207	34,427,207
Rezerva te tjera kapitali		652,681,096	358,266,276
Fitimi i pashpërndarë		246,958,452	207,507,156
<b>Totali i kapitalit</b>	18	<b>2,299,311,109</b>	<b>1,965,444,993</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>3,080,745,183</b>	<b>2,648,084,910</b>

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# ABCOM sh.p.k

## PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

(Të gjithë shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe)

Te ardhura	Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shitje shërbimesh	19	1,491,607,245	1,230,522,126
Te ardhura te tjera	20	1,399,911	585,755
<b>Te ardhurat totale</b>		<b>1,493,007,157</b>	<b>1,231,107,881</b>
Te ardhura nga distribucioni			168,605,451
Shpenzime nga distribucioni			(168,605,451)
<b>Distribucioni neto</b>	21	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Kostot operative</b>			
Kosto e materialeve, shërbime interneti, dhe te tjera	22	(576,540,525)	(518,178,487)
Shpenzime për personelin	23	(382,572,429)	(340,821,551)
Zhvlerësim dhe amortizim	9,10	(347,218,179)	(311,700,860)
Shpenzime administrative dhe te tjera	24	(173,719,284)	(155,642,942)
Situacione punimesh për nevoja te brendshme	25	259,534,335	316,254,794
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>		<b>(1,220,516,082)</b>	<b>(1,010,089,046)</b>
<b>Fitimi neto nga operacionet</b>		<b>272,491,075</b>	<b>221,018,835</b>
Totali i te ardhurave nga shitja e aktiveve afatgjata	27	16,570,856	14,230,435
Totali i shpenzimeve financiare neto	28	(4,426,144)	(2,598,725)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>284,635,787</b>	<b>232,650,545</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	29	(45,192,339)	(25,143,389)
<b>Fitim për vitin</b>		<b>239,443,448</b>	<b>207,507,156</b>

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË**

(Të gjithë shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<b>Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytëzimit</b>			
Fitimi para tatimit		<b>284,635,787</b>	<b>232,650,545</b>
Rregullime për:			
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	9	10,404,303	5,972,867
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	10	336,813,877	305,727,992
Shpenzimet për borxhin e keq		-	9,738,004
<b>Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit para rregullimeve në kapitalin punues</b>		<b>631,853,967</b>	<b>554,089,408</b>
Rritje e llogarive te arketueshme dhe te tjera		(47,448,852)	(82,867,344)
Rritje ulje e inventarëve		(111,577)	(6,862,640)
Rritje në furnitorë dhe te tjera detyrime		103,130,514	144,812,145
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>687,424,052</b>	<b>609,171,570</b>
Tatimi mbi fitimin i parapaguar		(48,040,384)	(23,276,688)
<b>Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>639,383,668</b>	<b>585,894,882</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit</b>			
Shitje e aktiveve afatgjata materiale		16,570,856	14,230,435
Blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale	9,10	(536,957,757)	(580,887,696)
Blerje TV Kruja shpk		(22,789,698)	(12,170,846)
Blerje A-Vizion shpk		(22,302,022)	-
Blerje First nation shpk		(42,003,209)	-
<b>Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (përdorur ne) veprimtaritë e investimit</b>		<b>(607,481,830)</b>	<b>(578,828,106)</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare</b>			
Financime (pagesa) nga qiraja financiare		9,009,763	-2,694,894
<b>Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (përdorur ne) veprimtaritë financiare</b>		<b>9,009,763</b>	<b>-2,694,894</b>
Rritja/(ulja) neto e mjeteve monetare		40,911,602	4,371,882
Mjete monetare me 1 Janar		95,474,833	91,102,951
<b>Mjete monetare me 31 Dhjetor</b>	<b>4</b>	<b>136,386,435</b>	<b>95,474,833</b>

# ABCOM sh.p.k

## PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

(Të gjithë shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe)

	Kapitali i Regjistruar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Gjendja më 01 Janar 2013</b>	<b>1,365,244,354</b>	<b>34,427,207</b>	<b>215,744,884</b>	<b>142,521,395</b>	<b>1,757,937,840</b>
Fitimi i periudhës	-	-	-	207,507,156	207,507,156
Rritje rezervash	-	-	142,521,395	-142,521,395	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>1,365,244,354</b>	<b>34,427,207</b>	<b>358,266,279</b>	<b>207,507,156</b>	<b>1,965,444,996</b>
<b>Gjendja më 01 Janar 2014</b>	<b>1,365,244,354</b>	<b>34,427,207</b>	<b>358,266,279</b>	<b>207,507,156</b>	<b>1,965,444,996</b>
Fitimi i periudhës	-	-	-	239,443,448	239,443,448
Rritje rezervash	-	-	207,507,156	(207,507,156)	-
Shtesa përthithje Star TV	-	-	63,659,867	1,985,182	65,645,049
Shtesa përthithje Trio TV	-	-	31,744,873	(2,967,257)	28,777,616
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2014</b>	<b>1,365,244,354</b>	<b>34,427,207</b>	<b>358,266,279</b>	<b>207,507,156</b>	<b>1,965,444,996</b>

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë aprovuar nga drejtuesit e saj më 26 Mars 2015 dhe janë firmosur në emër të tyre nga:

Genti Daci  
Administrator



Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## **1. Informacion i përgjithshëm**

Abcom sh.p.k. ("Shoqëria") është krijuar më datën 16 Prill 1998. Shoqëria është regjistruar në autoritetet tatimore me Numër Identifikimi të Personit të Tatuësëm (NIPT) K11308001B.

100% e kuotave të shoqërisë zotërohen nga American Broadband B.V. me seli në Holandë.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është ndërtim rrjetesh telekomunikacioni dhe ofrimi i shërbimeve të telekomunikacionit, internetit, telefonisë fikse, televizion me pagesë, etj. nëpërmjet sistemeve kabllore.

Administratorë të shoqërisë janë Z. Genti Daci dhe Z. Altin Leksani.

Më 31 Dhjetor 2014 shoqëria kishte 418 punonjës (2013: 358 punonjës).

Selia e shoqërisë është në Rr. Reshit Collaku, mbrapa Albtelekom, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria e kryen aktivitetin e saj në disa qytete të Shqipërisë. Shtrirja gjeografike e shërbimeve të kompanisë përfshin qytetet Tiranë, Shkodër, Lezhë, Krujë, Laç, Elbasan, Durrës, Lushnje, Kuçovë, Fier, Vlorë, Librazhd, Pogradec, Korçë, etj.

## **2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë dhe bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të zbatuara në Shqipëri në saj të Ligjit nr. 9228 datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, dhe të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe Ministria e Financave.

Sipas SKK 11 "Mbi Tatim Fitimin", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra në pasqyrat financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2014.

Drejtimi ka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të parimit të vijimësisë. Në marrjen e këtij vendimi, drejtimi mori në konsideratë planet e biznesit të shoqërisë, përfshirë këtu parashikimet e fitimit dhe mjeteve monetare si edhe ecurinë aktuale.

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë, monedha e ambientit ekonomik kryesor në të cilin shoqëria kryen aktivitetin e saj.

### **2.2. Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të ushtrojë gjykim në procesin e vlerësimeve dhe supozimeve që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga këto rishikime.

Në veçanti, informacioni në lidhje me fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurisë dhe gjykimeve në zbatimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të konsiderueshëm ndaj shumave të njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

### **2.3. Instrumente financiarë**

Instrumentet financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentet financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Pas njohjes fillestare instrumentet financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### ***Mjete monetare dhe ekuivalente***

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit të tyre. Mjetet monetare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.



***Llogari të arkëtueshme***

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme përllogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha të drejtat sipas kushteve fillestare të tyre. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme janë të mbivlerësuara. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara monetare të skontuara me normën efektive të interesit.

***Llogari të pagueshme***

Llogaritë e pagueshme njihen me vlerë të drejtë dhe maten më pas me kosto të amortizuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

***Huamarrjet***

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe maten më pas me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

***Të tjera***

Instrumente të tjerë financiar jo-derivativë maten me kosto të amortizuara sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

***Vlera e drejtë***

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar, huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

**2.4. Aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale**

Aktivët afatgjata materiale dhe jomateriale janë pasqyruar në librat e shoqërisë me koston e tyre historike minus zhvlerësimin e akumuluar.

***(i) Njohja dhe matja***

Të gjitha aktivët afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, nëse ka të tilla.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit mbarten nën aktive afatgjata jo-materiale dhe aktive financiare dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur zbatohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

***(ii) Kostot e mëpasshme***

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

***(iii) Amortizimi***

Amortizimi i aktiveve jomateriale dhe përmirësimit të ambienteve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit dhe duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të gjitha aktivët e tjera afatgjata mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Normat vjetore të zhvlerësimit të aplikuara janë si me poshtë:

	<b>Normat e zhvlerësimit %</b>	<b>Baze e llogaritjes</b>
<b>Aktivet afatgjata materiale</b>		
Ndërtesa	5	Vlera kontabël neto
Makineri dhe pajisje	20	Vlera kontabël neto
Mobilie dhe orëndi	20	Vlera kontabël neto
Pajisje elektronike	25	Vlera kontabël neto
<b>Aktivet afatgjata jomateriale</b>		
Programe kompjuterike	25	Vlera kontabël neto
Të tjera aktive jo-materiale	15	Kosto

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale rishikohet për rënie në vlerë kur ndryshimet e rrethanave tregojnë që vlera kontabël mund të mos jete e rikuperueshme. N.q.s. rrethana të tilla ekzistojnë dhe kur vlera kontabël tejkalon vlerën neto të realizueshme, aktivet ose njësitë gjeneruese të parasë do të pakësohen në vlerën e tyre të realizueshme dhe humbjet nga rënia e vlerës njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## **2.5. Aktivet dhe detyrimet financiare**

Aktivët dhe detyrimet financiarë konsistojnë tërësisht në llogari të arketueshme dhe llogari të pagueshme dhe janë pasqyruar në bilanc bazuar në shumat e faturuara.

Provizionet për borxhet e këqija njihen kur shumat konsiderohen të pambledhshme. Provizionet për borxhet e këqija është vlera e llogaritur nga drejtimi për të absorbuar humbje të mundshme në të ardhmen për llogari të arketueshme ekzistuese që mund të bëhen të pambledhshme si pasojë e kushteve ekonomike ekzistuese, rreziqeve të qenësishme dhe të cilësisë së klientëve dhe faktorëve të tjerë relevant, që sigurojnë njohjen aktuale. Vlera e humbjeve specifikisht e identifikuar (p.sh. klientë të klasifikuar si të dyshimta dhe të humbur) njihen si shpenzime dhe zbriten nga totali i llogarisë së arketueshme për atë klient si provizion për borxhet e këqija.

## **2.6. Zhvlerësimi**

### *(i) Aktivet financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### *(ii) Aktivet jo-financiare*

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## **2.7. Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

## **2.8. Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### **2.9. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

Tatim fitimi llogaritet me 15 % për vitin 2014 (31.12.13: 10%) mbi fitimin e tatueshëm

### **2.10. Detyrime për sigurimet shoqërore**

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave kur ndodhin.

### **2.11. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

## **3. Bashkimi i shoqërive**

Abcom ka përfunduar me 30 Qershor 2014 përthithjen e shoqërive Star TV shpk dhe Trio TV shpk të cilat zotëroheshin 100% nga Abcom shpk. Regjistrimi i asetëve dhe detyrimeve të shoqërive Star TV shpk dhe Trio TV shpk është bere me 01 Korrik 2014 në librat kontabël të Abcom duke eliminuar llogaritë e investimit detyrimeve dhe të drejtave që rezultojnë midis shoqërisë përthithëse dhe shoqërive përthithura në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit 09 "Kombinimet e Bizneseve", ku specifikohet se:

- Bashkimi ligjor mes shoqërisë mëmë dhe njësisë plotësisht të kontrolluara prej saj nuk përbën kombinim biznesesh, pasi shoqëria mëmë dhe njësitë e kontrolluara prej saj, që para së të bashkoheshin, ishin një njësi e vetme ekonomike.
- Bashkimi ligjor i shoqërisë mëmë me njësitë e kontrolluara plotësisht prej saj nuk do të ndikojë në pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë mëmë. Që nga momenti kur ndodh bashkimi ligjor, shoqëria mëmë do t'i çregjistrojë nga pasqyrat e saj financiare aksionet e zotëruara në njësinë e kontrolluar prej saj, do të njohë në pasqyrat e saj aktivet dhe detyrimet e shoqërisë së kontrolluar, si dhe të ardhurat dhe shpenzimet zë për zë (në të njëjtën mënyrë, si në pasqyrat financiare të konsoliduara).

## **4. Vlerësimet e rëndësishme kontabël dhe supozimet**

Ne aplikimin e politikave kontabël të shoqërisë, që përshkruhen në Shënimin nr. 2, nga drejtimi kërkohet që të beje gjykime, vlerësime, dhe supozime për vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë të qarta nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuar në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen relevant. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet tek vlerësimet kontabël do të njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar n.q.s. rishikimi afekton vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudha të ardhshme n.q.s. rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe të ardhme.

### **Pasiguria në gjykime**

#### ***Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare***

